Shoqata Bjeshkatare “TETOVA”

SHARRI
RRËFIME NGA SHTIGJET E EGRA



Tetovë, 2024

Botues: Shoqata Bjeshkatare “TETOVA”

Redaktor: Mislim Hasipi

Lektor: Florent Bajrami

Shtypshkronja: BoroGrafika-Shkup

Tirazhi: 100 copë

CIP -

Disclaimer: Mbështetja e CNVP-it ndaj këtij publikimi nuk përbën miratim të përmbajtjes, pasi përmbajtja është përgjegjësi e autorëve. CNVP nuk mbanë përgjegjësi për informacionet e këtij publikimi.

PËRMBAJTJA

5 Parathënje

7 Hyrje

11 Ditëlindja e pare

14 Maja e Titos

18 Lugina e Leshnicës

24 Xholi pa fund

28 Liqeni i Jazhincës

31 Luboteni nga mbrapa

35 Kobilica me shkas

38 Udha e bukës


42 Kronikë nga Sharri

47 Dukati

49 Marshi i Nëntorit në Sharr

52 Korabi dhe lulja e Moravës





Parathënie

I nderuar lexues,

Në këtë përmbledhje të veçantë të tregimeve, ju ftojmë të zbuloni magjinë e malit Sharr, një vend ku çdo majë dhe çdo shteg rrëfen një histori. Këto faqe janë mbushur me përjetime të bjeshkatarëve nga Shoqata Bjeshkatare "Tetova", të cilët ndajnë me ju, jo vetëm sfidat dhe gëzimet e ngjitjeve malore, por edhe humorin, barcoletat dhe çastet e paharrueshme që i bëjnë këto udhëtime unike.

Këtu do të gjeni dymbëdhjetë tregime të përzgjedhura me kujdes, secila prej të cilave tregon për një udhëtim ndryshe—nga freskia e papërshkruar në Leshnicë deri te horizontet pa kufi në Kobilicë. Çdo rrëfim është një ftesë për të ndjerë emocionet e një bjeshkatari, për të përjetuar kënaqësinë e arritjes në majë dhe për të mësuar mbi lidhjen e thellë mes njeriut dhe natyrës.

Gjithashtu, kjo përmbledhje është një dëshmi e angazhimit të palodhshëm dhe pasionit të gjithë anëtarëve të Shoqatës Bjeshkatare "Tetova", që e bën çdo ngjitje një aventurë të re, e njëherësh shprehim mirënjohje të thellë për anëtarët Florent Bajrami dhe Mislim Hasipi që dhanë kontribut të pashoq në shkrimin dhe përshtatjen e tregimeve për të krijuar këtë botim. Falë përkrahjes së CNVP, këto tregime u bënë të mundura edhe për auditorin më të gjerë, duke theksuar partneritetin e tyre të vazhdueshëm dhe miqësinë e përjetshme me shoqatën.

Ndërsa përshkoni këto faqe, lejoni që historitë të ju sjellin afër gjallërisë dhe sfidave të malit, dhe ju ftojmë të merrni frymën e malit Sharr, të ndjeni rrahjet e zemrës së natyrës dhe të gjeni një pjesë të vetes në këto përjetime. Kjo përmbledhje nuk është thjesht një libër; ajo është një udhëtim nëpër thesaret e maleve dhe zemrat e atyre që i duan ato.

Ju ftojmë të hyni në botën e bjeshkatarëve, të ndani kënaqësinë e çdo hapi në shtigje dhe të ktheheni në shtëpi të pasuruar me kujtime të reja. Shijoni çdo rrëfim dhe le të jenë këto tregime frymëzimi për udhëtimet tuaja të ardhshme në natyrë.

Për ju,
Shoqata Bjeshkatare “Tetova”
Tetovë, 2024

Hyrje

Ky botim që mbani në duar ju fton në një udhëtim të rrallë përmes rrëfimeve të gjalla dhe frymëzuese të marra nga shtigjet dhe majat e Malet e Sharrit. Këto male, të shtrira ndërmjet Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, janë jo vetëm një peizazh i mahnitshëm natyror, por edhe një thesar i pasur i biodiversitetit dhe një dëshmi e veprimtarive kulturore që kanë zhvilluar dhe ndikuar në këtë rajon përgjatë mijëra viteve.

Gjeografia dhe Ekosistemi

Malet e Sharrit përfaqësojnë një zinxhir malesh që shtrihet në një gjatësi prej rreth 80 kilometrash, të mbushura me majat malore që sfidojnë qiellin dhe liqenet akullnajore që shkëlqejnë si sytë e një gjigandi që vështron historinë e lashtë të Ballkanit.

Mali Sharr për nga pozita gjeografike gjendet në drejtimin verilindje-perëndim-jugperëndim, dhe gjenden në pjesën veriperëndimore të R. së Maqedonisë së Veriut. Kështu kokëlartë fillon nga Lepenci, pra nga maja Luboten (2499m) dhe përfundon me Majen Morava (2147m), më saktë me rrjedhjen e sipërme të lumit Radika dhe anën veriore të liqenit të Mavrovës. Nga ana juglindore Sharri në mënyrë të mprehtë është i kufizuar me luginën e Pollogut, kurse nga ana verilindore, veriore, veriperëndimore dhe jugperëndimore është i kufizuar me grykën e Kaçanikut, luginën e Bistricës së Prizrenit. Malin e Sharrit e karakterizon një projeksion horizontal shumë i gjerë me një gjatësi prej 76 km, dhe me sipërfaqe prej 1600 m2. Lartësia e mesatare e shpatit është 2200 m, ku mbisundon Maja e Titos me 2747 m.

Këto male janë të famshme për relievin e tyre të thyer, dhe janë shtëpi për 27 liqene të njohura si “Sytë e Sharrit”, të cilat janë një nga karakteristikat më të veçanta të këtij peizazhi.

Flora dhe Fauna në Malet e Sharrit

Malet e Sharrit, një nga ekosistemet më të larmishme në Ballkan, janë shtëpia e një diversiteti të pasur biologjik. Këto male mbajnë brenda tyre më shumë se 1260 lloje bimësh vaskulare dhe qindra specie të myshqeve, kërpudhave, dhe likeneve, shumë prej të cilave janë unike për këtë rajon.

Flora - Pyjet në Malet e Sharrit janë të veçanta për shkak të kombinimit të tyre të ahut dhe lisit, që dominon peizazhin, së bashku me bredhin, gështenjën, rrëpinë malore dhe shkozën. Këtu gjenden gjithashtu specie bimore endemike dhe relike si pisha e Maqedonisë (Pinus peuce) dhe pisha e malit (Pinus mugo), që ofrojnë një dëshmi të gjallë të historisë së lashtë gjeologjike dhe klimatike të rajonit.

Fauna -Nga ana e faunës, Malet e Sharrit mbrojnë një gamë të gjerë të specieve të kafshëve, duke përfshirë disa që janë të rralla dhe të rrezikuara. Ato përfshijnë ariun e murrmë (Ursus arctos), rrëqebullin euroaziatik (Lynx lynx), dhe ujkun (Canis lupus). Këto male janë gjithashtu vendstrehim për një numër të madh të shpendëve, përfshirë shqiponjën e artë (Aquila chrysaetos) dhe gjelin e egër (Tetrao urogallus), si dhe për shpendë grabitqarë të tjerë si skifteri kthetrabardhë (Falco naumanni) dhe shkaba e grifonit (Gyps fulvus).

Zona e ujërave të ëmbla - Liqenet dhe lumenjtë e Sharrit janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e specieve të ujit si trofta endemike dhe kaliforniane, si dhe për 11 lloje amfibësh dhe 17 lloje zvarranikësh që jetojnë në këto habitat ujor. Këto zonat e ujit jo vetëm që mbështesin jetën ujore, por edhe ndihmojnë në ruajtjen e një ekosistemi të shëndetshëm përgjatë të gjithë malit.

Përmes ruajtjes së këtyre ekosistemeve të ndryshme dhe ndërveprimit të tyre, Malet e Sharrit vazhdojnë të ofrojnë një burim vital për studimin dhe kuptimin e biodiversitetit, si dhe një vend për njerëzit të përjetojnë dhe mësojnë rreth mrekullisë së natyrës.

Rëndësia Kulturore dhe Mbrojtja Ndërkufitare

Shpallja e disa pjesëve të këtyre maleve si parqe kombëtare në tri shtetet fqinje është një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e këtij peizazhi natyror dhe në promovimin e një menaxhimi të përbashkët ndërkufitar. Kjo iniciativë ndihmon në ruajtjen e biodiversitetit dhe në zhvillimin e turizmit ekologjik, duke ofruar një model për bashkëpunimin rajonal dhe mbrojtjen e mjedisit.

Lidhja me Tregimet

Secila nga 12 tregimet që do të ndiqni në këtë botim është jo vetëm frymëzuar nga peizazhet magjepsëse të Malet e Sharrit, por edhe thellësisht e rrënjosur në pasurinë e madhe natyrore dhe kulturore që këto male ofrojnë. Këto rrëfime të veçanta janë të mbushura me përvoja dhe ndjesi të bjeshkatarëve dhe eksploruesve, të cilët kanë marë pjesë në udhëtime të ndryshme përgjatë shtigjeve të fshehura dhe majave sfiduese të këtij masivi malor.

Çdo tregim, qoftë një përshkrim i një ngjitjeje të vështirë në një nga majat më të larta, një qëndrim pranë liqeneve akullnajore që pasqyrojnë qiellin si sytë e gjigandëve të fjetur, apo një eksplorim i biodiversitetit të pasur që mbretëron në pyjet e thella, sjell në jetë histori të ndryshme që reflektojnë marrëdhënien e ndërlikuar mes njeriut dhe natyrës.

Këto tregime i japin zë aventurave personale dhe kolektive të atyre që kanë guxuar të sfidojnë vetveten në kushte të ndryshme, duke përballuar terrene të rraskapitura dhe kushte atmosferike që testojnë kufijtë e tyre fizikë dhe emocional. Ato gjithashtu shpalosin ndikimin transformues që këto peizazhe kanë pasur mbi ata që i kanë përjetuar—nga ndjesia e triumfit dhe respekti ndaj natyrës deri tek rritja personale dhe kuptimi më i thellë i vetëdijes ekologjike.

Nëpërmjet këtyre rrëfimeve, ne synojmë të theksojmë rëndësinë e ruajtjes së këtyre peizazheve si dhe të nxisim një vlerësim më të madh për rolin që çdo individ mund të luajë në mbrojtjen e mjedisit. Është shpresë e fortë që ky botim do t'ju frymëzojë jo vetëm të lexoni me kureshtje për aventurat e treguara, por edhe të ndiheni të thirrur për të zbuluar dhe mbrojtur bukuritë natyrore që na rrethojnë.

Ftesa

Ju ftojmë të zhyteni në këto faqe, të ndiqni shtigjet që kalojnë përmes gjelbërimit të Sharrit dhe të përjetoni magjinë që çdo tregim sjell me vete. Kjo përmbledhje nuk është vetëm një rrëfim i eksplorimeve malore; është një dëshmi e lidhjes së thellë midis njeriut dhe natyrës, midis kulturës dhe peizazhit që na rrethon.


Ne shpresojmë që kjo përmbledhje të ju frymëzojë jo vetëm të vizitoni Malet e Sharrit, por edhe të merrni pjesë në përpjekjet për të ruajtur këtë thesar natyror për brezat që do të vijnë.


Ditëlindja e parë

Si sot një vit më parë, një grup bjeshkatarësh me përvojë dhe me shtytjen e disa bjeshkatarëve “pleq” ama axhamoj, u organizuan dhe vendosën ta themelonin Shoqatën Bjeshkatare “Tetova”. Edhe pse Tetova ka shumë bjeshkatarë, mungonte organizimi dinjitoz i tyre, si dhe përfaqësimi nën një ombrellë të përbashkët. Padyshim që entuziazmi ishte i madh dhe pritshmëritë ishin të larta po ashtu. Megjithatë askush nuk do ta besonte që për një periudhë shumë të shkurtër kjo shoqatë do të konsolidohej në këto përmasa.



Sot patëm nderin dhe kënaqësinë që në vigjilje të përvjetorit tonë të parë të mirëpresim hiç më pak se 400 mysafir nga vendi dhe rrethina. Shoqata bjeshkatare si dhe dashamirë të natyrës kishim nga : Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Presheva, Sanxhaku etj. Me prezencën e tyre na nderuan edhe kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, përfaqësuesit e CNVP-së, klubit rotarian etj.





Në ora 7 u shfaqën veturat e para tek pikë-takimi jonë fillestar, ish-stacioni i teleferikut. Ndërsa minutave në vazhdim numri vetëm po shtohej e njëkohësisht po shtohej edhe buzëqeshja tek anëtarët e kryesisë, që po i mirëprisnin mysafirët.



Në hyrje të fshatit Shipkovicë, një antar nga nikoqirët po i orientonte veturat që ta shmangnin këtë kthesë dhe të vazhdonin ngjitjen drejt Gurit të Sidollit, e një tjetër po i priste lartë për t'i orientuar tek vend parkimi i improvizuar enkas për këtë ngjarje.

Tek parkingu, organizatori ndau bluza për të gjithë pjesëmarrësit dhe për pak minuta filloi të dominonte ngjyra e bardhë. Kryetari i ShB"Tetova" - Sejdi Halili, mbajti fjalim rasti ku i mirëpriti mysafirët dhe pas përfundimit të fjalimit i priu për tek "Stanet e Shipkovicës".



Tek Stanet e Shipkovicës mysafirët u mirëpritën me çaj të freskët mali dhe ëmbëlsira, e me të përfunduar çajin, grupi u nis drejt Udhës së Mulakave me destinacion përfundimtar Gjurin e Lopëve (siç thirret nga vendasit). Falë numrit të madh të mysafirëve shtegu gjarpëror u shenjëzua nga ngjyra e bardhë e bluzave të pjesëmarrësve, gjë që ja shtoi edhe më tepër madhështinë kësaj ngjarje.

Me të arritur tek Gjuri i Lopëve, mysafirët patën mundësinë të çlodhen dhe të shijojnë pamjet mahnitëse nga ky kënd i Sharrit, dhe ajo që binte në sy ishte laramania në moshë e pjesëmarrësve nga fëmijë të vegjël, ku më i riu ishte vetëm 4 vjeçar, e deri tek mysafirë afër 80 vjeçar.

Kthimi u bë nga shtegu i pyllit të dendur të Jellak-ut, për të përfunduar tek Stanet e Shipkovicës, aty ku ekipi tjetër i nikoqirëve mirëpriti mysafirët me groshën e famshme të Tetovës, sallatë e ëmbëlsirë.

Pas përfundimit të drekës, u ndanë mirënjohjet dhe falënderimet për shoqatat bjeshkatare dhe individë që ndihmuan për mbarëvajtjen e këtij si dhe aktiviteteve të tjera të ShB"Tetova".

Për fund, por jo më pak e rëndësishmja, vlen të theksohet se kjo ngjarje u organizua në kuadër të projektit "Sharri- Trashëgimi kulturore" si pjesë e projektit "Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore në Korab-Koritnik, Malin Sharr dhe Alpet Shqiptare" që implementohet nga CNVP Foundation dhe financohet nga Prespa Ohrid Nature Trust - PONT.

Maja e Titos

Maja e Titos, e njohur gjithashtu si Turku i Madh apo Maja e Sharrit, është një ndër destinacionet më të njohura dhe tërheqëse për bjeshkatarët në Maqedoninë e Veriut. E vendosur në masivin malor të Sharrit, kjo maje mbart një histori të pasur dhe shumëdimensionale, e cila reflektohet edhe në emërtimet e saj të shumta. Çdo emër tregon për periudhat e ndryshme historike dhe regjimet që kanë ndikuar në këtë rajon. Ndërsa "Maja e Sharrit" dhe "Turku i Madh" reflektojnë ndikimet e hershme osmane, emri "Maja e Titos" i atribuohet periudhës së Jugosllavisë, kur ky vend u bë i njohur për entuziastët e natyrës dhe bjeshkatarët nga të gjitha anët.



Ngjitja drejt kësaj maje, e cila ngrihet në lartësinë prej 2747 metrash mbi nivelin e detit, është një përvojë unike që ofron pamje mahnitëse të maleve përreth dhe të horizontit të pafund. Në ditë të kthjellëta, nga maja mund të shihet deri në distanca të largëta, duke e bërë atë një pikë referimi për bjeshkatarët dhe adhuruesit e natyrës. Por për t'u ngjitur deri në Majën e Titos kërkohet përkushtim dhe përgatitje fizike. Shumë prej bjeshkatarëve përgatiten me muaj të tërë për këtë ngjitje, tërhequr jo vetëm nga bukuria e natyrës, por edhe nga sfida që kjo rrugë paraqet.

Ngjitja zakonisht fillon nga Kodra e Diellit, një vend i njohur turistik, dhe zgjat rreth 4-5 orë, në varësi të nivelit të përgatitjes së bjeshkatarit. Disa bjeshkatarë të pasionuar arrijnë ta përshkojnë këtë rrugë për më pak se 4 orë, por këto raste janë të rralla. Rrugët për të arritur në majë janë dy: rruga verore, e njohur si "*Rruga e Vakaufit*", dhe rruga dimërore, e cila kalon përmes disa majave të tjera si Ceripashina (2480 m), Maja e Kaltërt (2551 m), Bakërdani (2704 m) dhe përfundon në Majën e Titos.

Çdo bjeshkatar që përballet me këtë sfidë e di që ngjitja është gjithçka, përveç se e thjeshtë. Rrugët janë të mbushura me terrene të ashpra, kthesa të papritura, dhe shpesh me ndjesinë e lodhjes së madhe. Shumë kollaj të shkruhen lartësitë mbidetare, por ama bjeshkatarët e dinë se për t'u ngjitur deri të Maja e Titos, disa herë "*del shpejrti*", disa herë "*vejn prap*", veçanërisht një pjesë e njohur si vendi ku *pordhën kali*! Një nga pikat më sfiduese të ngjitjes është një vend i pjerrët, ku shumë bjeshkatarë humbasin frymëmarrjen dhe përballen me një sprovë të vërtetë fizike.


Megjithatë, me çdo hap që hedh, çdo lodhje kompensohet nga pamjet e mahnitshme që shpalosen para syve. Peizazhet e fushës së Pollogut dhe majat e tjera që të rrethojnë, janë një spektakël natyror që të mbush me frymëzim dhe respekt për fuqinë e natyrës.

Kur arrin në majë, ndjenja e triumfit është e paçmueshme. Maja e Titos të përshëndet me kullën e saj të njohur, e cila qëndron atje si një dëshmi e historisë dhe trashëgimisë që e mbart kjo zonë. Nga kjo lartësi, mund të shohësh gjithë bukurinë e Sharrit, fusha të gjelbra dhe male të mbuluara me dëborë, që duket sikur zgjasin pafund. Aty, në qetësinë absolute të lartësisë, bjeshkatarët ndalojnë për të pushuar, për të reflektuar mbi përvojën dhe për të shijuar arritjen e tyre. Ndonëse ngjitja ka qenë sfiduese dhe e lodhshme, përvoja është një triumf personal dhe shpirtëror për çdo individ që arrin majën.



Maja e Titos është më shumë sesa thjesht një destinacion për bjeshkatarët; është një simbol i natyrës së papërkulshme dhe sfidave që ajo vendos para nesh. Për shumë njerëz, ngjitja në këtë majë nuk është vetëm një test i forcës fizike, por edhe një udhëtim emocional dhe mendor. Është një përvojë që të mëson përkushtimin, durimin, dhe lidhjen e thellë me natyrën. Me çdo hap që hedh në këtë udhëtim, natyra të ndihmon të kuptosh rëndësinë e sfidave dhe bukurinë që gjendet në përpjekjet për t'i kapërcyer ato.

Çdo vit, mijëra bjeshkatarë vijnë nga vende të ndryshme për të përjetuar këtë aventurë. Disa kërkojnë një sfidë fizike, të tjerë vijnë për të shijuar natyrën e pastër, ndërsa të tjerë ngjiten për të ndjekur historinë e kësaj maje të famshme. Pavarësisht arsyes që i shtyn, një gjë është e sigurt: përvoja e ngjitjes në Majën e Titos është e paharrueshme dhe mbetet në kujtesën e çdo bjeshkatari që ka fatin ta përjetojë. Maja e Titos mbetet një simbol i fuqisë së natyrës dhe një vend ku njeriu përballet me veten, për të zbuluar forcën dhe vendosmërinë e tij më të madhe.


FATMAP
Feedback
Get The App
Spring start
Shkoza Jullak
2D
3 - 4
10.7
1,808 - 2,724
1,014
98
14

Lugina e Leshnicës, margaritari i Sharrit që çdo stinë ripërtrihet

Të tunduar nga njoftimi i nikoqirit, ShB "Tetova", për organizimin e ngjarjes "Ecje dimërore në Luginën dhe Ujvarat e Leshnicës", vendosëm që t'i bashkohemi këtij organizimi, ashtu si miqtë tanë bjeshkatarë nga ShBA "Kastrioti" i Ferizajit të Kosovës. Vendtakimi ishte caktuar tek ish-stacioni i teleferikut, që dikur lidhte Tetovën me Kodrën e Diellit, me anë të gondolave modeste, por që ishin mjaft solide për atë periudhë, e që ndaloi të funksionojë që nga koha e konfliktit të armatosur të vitin 2001. Për fat të keq të bjeshkatarëve dhe turistëve, tashmë për 22 vite, ky aset i rëndësishëm i Tetovës mbeti vetëm një relikë e pavlerë. E si për ironi të fatit, pjesa dërrmuese e bjeshkatarëve e shfrytëzojnë pikërisht këtë lokacion si pikë-takim për ngjitjet e fundjavave. Thuaja se duam t'ia rikujtojmë vetes se si dikur mund të shmangim tërësisht përdorimin e veturave, ndërsa sot vetëm mund ta vrojtojmë nga jashtë rrethojave me nostalgji dhe keqardhje për vetveten.



Konsolidimi i grupit

Për pak minuta grupi fillon të konsolidohet. Një furistradë parkohet afër nesh, e shfaqet "Treshi", ashtu siç njihen tash e shumë vjet, grupi i tre shokëve dhe bjeshkatarëve të pandarë, doktor Rexhepi, laureati i çmimit Xhambazov (çmimi më i lartë që ndan Federata e Bjeshkatarisë së RVM-së), kryetari Sejdiu dhe arkëtari Naseri. Pas tyre si në varg afrohen grupi i sekretarit, Bujarit, i shoqëruar nga Florenti, Agimi dhe Rufati dhe të tjerët me radhë. Një fytyrë e re ua zgjon kureshtjen anëtarëve të shoqatës, a ai është Besari që po merr pamje filmik me kamerën e tij, që nga pamja duket mjaft profesionale. Ai ju bashkëngjit grupit me entuziazëm, duke shpresuar që në Leshnicë do të mundet të shkrep pamje të veçanta ashtu siç ja përshkruajnë Leshnicën shokët për rreth. Në anën tjetër Qenani, na njofton se për fat të keq mysafirët nga Kosova nuk do të mund të na bashkëngjiten, për arsye teknike, ashtu siç e njofton udhëheqësi i "Kastriotëve".

Fillimi i rrugëtimit nga rrëza e Sharrit drejt Malësisë së Tetovës

Pas përshëndetjeve të zakonshme mes anëtarëve dhe me gjithë keqardhjen për mungesën e mysafirëve, grupi niset me 5 vetura drejt Malësisë së Tetovës, me dëshirë për të arritur në fshatin e fundit të kësaj ane të Malësisë, fshatin Bozovcë. Rruga është e gjatë afër 22 kilometra dhe na merr rreth 50 minuta për të arritur në destinacionin tonë final. Me të arritur në fshat, parkojmë veturat, si dhe përshëndesim banorët, që si çdo herë janë mjaft mikpritës.

Drejt Mbretëreshës së Sharrit


Pasi përfundojmë me veshjen e këpucëve të thella, mbrojtëseve të borës dhe rregullimin e shtagave, grupohemi afër shkollës fillore të fshatit. Udhëheqësi i grupit na njofton se shtegu është i gjatë rreth 18-19 kilometër në të dy drejtimet dhe se ngjitjen do ta bëjmë nga shtegu i epërm ndërsa kthimin nga shtegu i poshtëm. Udhërrëfyes i këtij udhëtimi është Musliu, i lindur në Bozovcë, por i shpërngulur në Tetovë para shumë viteve, por që me kënaqësi na prin drejt këtij margaritari të vendlindjes së tij. Në fillim të shtegut, tek Rudina siç e quajnë vendasit, shkrepim foton e parë të grupit dhe vazhdojmë ecjen. Pushimin e parë e bëjmë tek një pikë mjaft mirë e rregulluar, me ulëse për të pushuar, çezëm

dhe një kasolle e vogël strehimi, që mund të na shërbejmë në rast të reshjeve të shiut. Udhërrëfyesi na njofton se pushimi i radhës do të jetë tek Gajrinat. Rrugës për në Gajrina na shfaqet një përrua i fuqishëm dhe kryeneç, që ndërpret rrugën mu në mes, nga prurjet e shumta të ujit, si për të na treguar se nga këtu e tutje fillon zona ku mbizotëron natyra e egër dhe jo njeriu. Banorët e zonës kanë ndërtuar një urë druri, që e bën një miks natyral për foto-sesion me përroin dhe që padyshim ua lehtëson lëvizjen turistëve të shumtë.

Ndalesa e dytë vjen në Gajrina të Poshtme dhe kjo është një nga pikat më pitoreske të kësaj ane. Në të djathtën tonë na shfaqet një liqen i vogël, që ja shton hijeshinë edhe më tepër kësaj kodrine. Nga e majta, me krenari shpon qiellin Maja e Ortegut (Pllati i Epërm), e poshtë saj në pyll, duket Liqeni që krijohet vetëm gjatë dimrit dhe në pranverë, nga shkrirja e borës. Në radhë vjen Guri i Mesëm (ose *Kepi i Nërmjem* siç e quajnë vendasit) që qëndron si gardian i Luginës së Leshnicës dhe pas tij Kepi i Tretë (*Kepi i Përtijm*). Duke vazhduar në anën e djathtë renditen: Maja e Brodit, Babahasanajca, Gjuri i Lodrës, e pak më poshtë saj vjen *Gjuri i Çamë* (i çarë), e poshtë tij vjen toponimi që quhet *Vorri i Shehit* (Varri i Shehut) dhe Gajrinat e Epërme. Pas pushimit të shkurtër në Gajrina të Poshtme, ecjen e vazhdojmë në drejtim të Leshnicës. Sapo na shfaqen pishat e larta, e kuptojmë se po hyjmë në territorin e Luginës së Leshnicës. Me të zbritur poshtë në Luginë rrugën na e pret lumi i vrullshëm i Leshnicës, si për të na qortuar se si dikur e braktisëm, pa mbrojtje, atëherë kur hidromafia mori leje për ta përvetësuar këtë margaritar. E megjithatë, falë shpalljes së Malit Sharr si Park Nacional, ky vendim u shfuqizua dhe gypat e çeliktë mbeten si një dëshmi e një turpi që malësorët e Sharrit e gëlltitën në heshtje atëbotë, pa tentuar t'i dalin zot kësaj zone, që njihet si zona më e bukur e masivit të Sharrit. Lumin e kalojmë në një urë druri, të ndërtuar nga fshatarët dhe njerëz të vullnetit të mirë, me shumë finesë, e në harmoni me ambientin përreth. Sapo kalojmë në anën tjetër, pas një ecje të shkurtër përskaj lumit, përpara na shfaqet një tabelë druri që na njofton se jemi në Parkun Nacional të Malit Sharr, të shoqëruar nga një hartë orientuese. Pas saj kalojmë edhe një pjesë të lumit mbi gypin e ujësjellësit të Tetovës që shërben si urë e improvizuar dhe arrijmë tek pishat e famshme të Leshnicës. Ky vend është mjaft i preferuar për kamping nga turistët e huaj dhe vendasit, meqë pamja është mjaft e bukur dhe relaksuese, ka ujë të pijshëm në formë çezmeje në afërsi (edhe pse lumi është vet i pijshëm) si dhe gjatë verës pishat shërbejnë si mburojë nga dielli i fortë. Pas pishave vijnë vilat e ish zyrtarëve komunist që dikur e shijonin të vetëm këtë margaritar të Sharrit dhe zona ishte rreptësisht e ndaluar për të tjerët. Udhëheqësi i grupit na njofton se këtu do të ndalemi për pauzën e radhës, dhe disa bjeshkatarë po mbledhin

drunjë të thatë që gjenden përreth, ndërsa një grup tjetër po tenton ta ndez zjarrin. Kjo pauzë u shfrytëzua edhe për të ngrënë drekën modeste që gjithsecili kishte marrë me vete, por që me shumë dashamirësi e ndajnë me të tjerët, si dhe u shfrytëzua për çlodhje nën shoqërimin e barcoletave të doktor Rexhepit.

Ecjen e vazhdojmë drejt Ujvarës së Leshnicës, ku pas një shtegu të shkurtër në pyjet e dendura të Leshnicës para nesh shfaqen shkallët e drurit që shpijnë drejt një guri që i ngjan shpellës. Në brendësi të saj fshihet një nga kryeveprat e kësaj ane, Ujvara e Leshnicës. Edhe pse ujvara nuk ka lartësi të madhe, forma karakteristike e saj, rrjedha e shpejtë dhe e ftohtë e ujit që i ka gdhendur gurët në formë mjaft interesante, e bën këtë ujvarë mjaft unike dhe atraktive për turistët,. Dikush pyet me shumë kureshtje "Ku shkon bre i gjithë ky ujë i kristaltë" ? dhe Bujari i përgjigjet në formën më të mirë të mundshme duke u përkulur, mbush duart me ujë dhe duke pirë me ëndje, "Eheee, ky burim furnizon thuaja se krejt Tetovën me ujë".




Kthimin e bëjmë nga shtegu i poshtëm, i tëri në mes pyjesh, dhe që për shkak të terrenit është edhe më i përshtatshëm për zbritje. Këtu profesor Nasufi gjen rastin të na shpjegojë për një nga drunjtë më karakteristik të kësaj zone, e që fatkeqësisht është edhe një nga llojet e rrezikuara, Tajsi apo Tisa siç njihet nga banorët e zonës, ose Taxus baccata në latinisht. Karakteristikë kryesore e këtij lloji të drurit është se shumë vështirë pritet, por edhe më vështirë kalbet, gjë që

e bën të përshtatshme të përdoret në gardhet e shtëpive të zonës, për shkak të qëndrueshmërisë.

Me të arritur në katund pushojmë për së fundi herë në kafene dhe kthehemi në pikënisjen tonë, nga ku vazhdojmë rrugën për në qytetin e Tetovës duke lënë prapa Bozovcën dhe Luginën e Leshnicës, këtë margaritar të Sharrit që në çdo stinë ripërtërihet dhe bëhet edhe më e bukur.



Foto: Tajsi apo Tisa (*lat: Taxus baccata*)


19:15
LTE
Bozovce-Leshnicë
Offline maps available for this area!
Maps
Legal
1.618 m
1.213 m
15,22 km
Explore
Record Trail
Profile
Premium

Xholi pa fund

Në lartësi prej rreth 2400 metrave mbi nivelin e detit dhe rreth 6 orë ecje prej Tetovës, gjendet njëri nga liqenet me më shumë gojëdhëna, të cilat janë sa interesante, aq edhe trishtuese! Liqeni, I cili nga banorët e malësisë njihet edhe si "Xholi pa fund", ofron një panoramë të paharruar për syrin e njeriut. Në fakt janë dy liqene, mirëpo vetëm njëri mbijeton tërë vitin, ndërsa ai më i vogli thahet nga mungesa e të reshurave.



Emri i tij ka ndryshuar paralelisht si kanë ndryshuar edhe *hiqimatet*, në kohën e paraluftës emrin e ka marrë nga një komandant me emrin Nikolla i cili supozohet se ka qenë i rreptë me popullatën dhe ua ka nxirë jetën, prej ku edhe liqeni është quajtur liqeni i Karanikollës (nga gjuha turke liqeni i Nikollës së zi), ky sqarim edhe vlerësohet si më i përafërti rreth sqarimit të emrit, ne do e përdorim emrin xhol.

Mirëpo ky liqen në vete mban edhe një gojëdhënë, e cila flet për lidhshmërinë e tij me liqenin e Treskës në Shkup. Gojëdhëna flet për një ngjarje kur një çobanit rastësisht I ka rra *janxhejki* (lloj strajce prej lëkurës së qengjit, për të mbajt ushqim gjatë ditës), në liqen. I njëjti as që e ka kërkuar, por ama kur është kthyer në shtëpi në vjeshtë, nusja ia tregon *janxhejkin*, e kështu çobani e zbulon lidhjen nëntokësore të dy liqeneve. Gojdhana vazhdon me atë që çobani javë për javë ka ther nga një dash nga kopeja dhe e ka hedhur në liqen, ndërsa nusja e tij e ka nxjerr në Treskë. Një ditë prej ditëve, pronari i kopesë e ka vërejt këtë veprim të çobanit dhe e vret atë, e fut në lëkurë dashi dhe e hudh në liqen dhe gojëdhëna thotë se kur e ka nxjerr nusja në anën tjetër, nga dëshprimi dhe shqetësimi i madh edhe ajo ka vdekur në moment!

Kjo gojëdhënë është përdorur edhe si shembull për edukim të popullatës, se nuk është mirë të vjedhësh, sepse kush vjedh mbaron tragjikisht!

Emri *Xholi pa fund*, pafundësia e tij është përdor si metodë për ndalimin e notimit të liqen, sepse pjesa më e madhe e popullatës nuk ka ditur të notojë dhe nga frika se mos mbyten, popullata ka thur lloj – lloj tregimesh për pafundësinë e tij.



Rruga për te Xholi fillon prej fshatit Veshallë, në këmbë ose edhe me vetura malore deri të Kroi i Abazit, vendtakim ky I cili ndan djathtas rrugën për në Prizren dhe majtas për te Xholi.

Përfundimisht, udhëtimi drejt Xholit pa fund është më shumë se një thjesht ekskursion; është një udhëtim në zemrën e folklorit dhe misterit të kësaj zone. Gojëdhënat dhe legendat që fshihen pas ujërave të tij të qeta janë një dëshmi e pasurisë kulturore që mbart ky vend. Çdo hap në këtë rrugëtim është një mësim i historisë së njerëzve që kanë jetuar këto anë dhe kanë ndërtuar një botëkuptim rreth natyrës që i rrethon. Në fund të ditës, Xholi pa fund nuk është vetëm një destinacion në hartën turistike, por një kapitull i gjallë i kulturës popullore që vazhdon të frymëzojë dhe të mësojë brezat e rinj për respektin ndaj natyrës dhe pasurive të saj të padukshme. Ky liqen, i mbushur me mister dhe legjenda, do të vazhdojë të jetë një burim i pashuar frymëzimi dhe një kujtim i qëndrueshëm për të gjithë ata që guxojnë të shkelin në brigjet e tij dhe të dëgjojnë historitë që flasin nëpër valët e tij.




Maps
3D
29275
Veshala
Maps
© Wikiloc | Leaflet
Legal


7,350 ft
4,048 ft
6.2 mi

Liqeni i Jazhincës

Me datë 18.08.2024 një grup bjeshkatarësh me përvojë shumëvjeçare, vendosëm që të sfidojmë veten me ngjitje deri te liqeni I Jazhincës në malin e Sharrit, liqen ky që gjendet në lartësinë më të madhe mbidetare, rreth 2180 mlm) e që gjendet në vijnë kufitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës.



Nisjet si zakonisht fillojnë më kifle dhe jogurt, se “thesi i mbrazët” nuk rri në këmbe, e për këtë arsye kiflet janë pjesë e pandashme dhe prej te stadiumi e deri në kufiri i “grijtëm kiflet”. Udhëtimi ishte i mrekullueshëm si gjithmonë, përgjatë rrugës së malit Sharr nga ana e Kosovës, me ç ‘rast në ora 8.00 arritëm

në vendin ku duhej të parkojmë automjetet, lokacion ky që përdoret pothuajse nga të gjithë bjeshkatarët, të cilët pikësynim e kanë liqenin e Jazhincës. Kësaj radhe ishin shumë bjeshkatarë të tjerë nga Shkupi, Hani I Elezit, Republika e Kosovës, etj.

Nga parashikimet sinoptike, kjo ditë nuk ishte nga ato që sigurojnë rehati të plotë, ngase ishte kohë me vranësira, prandaj edhe kishte propozime që të kthejmë në mes të rrugës, sepse kohë pas kohe kishte rrufe dhe dëgjoheshin bubullima, mirëpo vendosmëria dhe dëshira për tu fresku në ujërat e liqenit të Jazhincës e bëri që ne të shkojmë deri te caku përfundimtar.


Gjatë pauzës te liqeni i Jazhincës, edhe pse ishte moti me vranësira, disa nga bjeshkatarët e mbajtën premtimin dhe u zhytën për freskim në liqen, e disa për vjelje të qershizave të tokës apo siç i quan populli, boronicave, të cilat ishin me bollëk dhe si zakonisht eksploruesi i specieve bimore në malin Sharr, profesor Nasuf Abdii fotografonte speciet bimore dhe frutat jo drunore autoktone të asaj zone si p.sh. trëndafili- Rhododendron ferugineum, trëndafil i cili rritet vetëm në toka të pasura me minerale të hekurit.



Si gjithmonë, në kohën e pauzës shtruam edhe drekën e përbashkët në shkëmbinjtë për rreth liqenit dhe për dallim nga drekat e tjera që shtrojmë ne të Shoqatës Bjeshkatare „Tetova", sot na munguan barsoletat plus dhe minus 18, që enciklopedia e gjallë, doktori, i mban mend dhe me ëndje na i tregon, me çka na bën që lodhja të jetë më tepër relaksim dhe zbavitje.

Për dallim nga rruga, gjatë së cilës u ngjitëm deri te liqeni I Jazhincës, në kthim I "ramë" udhës më të shkurtë, andej nga liqeni I Jazhincës, një rrugë e cila ishte mjaft e pjerrët dhe kjo e bëri që na bjeshkatarët të ndjehemi mjaft të lodhur derisa arritëm te pikënisja e mëngjesit.

Përfundimisht, kjo ditë ishte e mbushur me emocione, sfida dhe bashkëpunim. Edhe pse moti na sfidoi me vranësira dhe bubullima të largëta, vullneti i përbashkët dhe pasioni për natyrën na çuan deri në majë. Mrekullia e liqenit të Jazhincës dhe peizazhet e malit Sharr, së bashku me shoqërinë e ngrohtë dhe të gëzueshme të anëtarëve të shoqatës, na bënë të harrojmë çdo lodhje. Çdo udhëtim i tillë na afron më shumë me njëri-tjetrin dhe na rikujton për thesarin e vërtetë që qëndron në zbulimin dhe përjetimin e bukurive natyrore të vendit tonë. Sfida dhe aventura e sotme do të mbetet një kujtim i çmuar, që do të na kujtojë për forcën dhe bukurinë që gjendet në bashkëpunimin dhe respektin ndaj natyrës.



Luboteni nga mbrapa

Të dielave, si zakonisht, ngjitemi në bjeshkë, por kësaj radhe, siç thotë doktori, me sebep, ecjen do ta bëjmë të Shtunën! Jemi mysafirë të bjeshkatarëve të SHB "Kaçaniku", të cilët, si çdo vit, edhe kësaj radhe e kanë hapur zemrën dhe festojnë 7 Shtatorin, ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në po të njëjtin qytet, pra në Kaçanik.

Prej Tetove nisemi me 4 vetura, të gjithë të gatshëm më shumë për aheng sesa për alpinizëm, por ama *"nauk nejset dita pa mantija, doktori nuk e lun komën pa mantija*", kështu që dëshira e doktorit është urdhër për të gjithë ne. Me të arritur në Han të Elezit, të cilit nga Hani vetëm emri i ka ngelur, të parët rreshtohemi te furra dhe marrim mantija sa na mbajnë duart dhe *"ham njen sa ti harxhitim",* thotë kryetari.


Kur shkohet në Kaçanik, nuk ka si të mos jetë festë, e festa bëhet më e madhe me miq të zemrës, thotë Ekremi, njëri nga organizatorët e manifestimit, i cili na pret, siç e ka zakonin, me përqafime dhe me foto të përbashkët në sheshin e Kaçanikut.

Ngjitja nis me shkallët e reja që kaçanikasit i ndërtojnë enkas për këto lloj manifestimesh, dhe rrugës kalojmë nëpër një dushkajë, e cila ofron freski pranverore, pa marrë parasysh në cilën stinë të vitit jemi. Me të kaluar "gurin e shpum", nga ku ofrohet pamje fantastike e autostradës Prishtinë – Shkup.



Autostrada Prishtinë-Shkup

Më tej vazhdojmë ngjitjen deri te rruga e Rimit (Romës), siç e quajnë banorët e fshatit Gjurgjedel rrugën Via Egnatia, e ndërtuar nga Perandoria Romake 2-3 shekuj para erës sonë.



Pamje e rrugës Via Egnatia diku mbi Kaçanik!

Bjeshkataria ofron një mundësi unike për socializim, por edhe për shkëmbim idesh dhe mendimesh të ndryshme, po aq edukative sa edhe zbavitëse; për shembull, të gjithë ne që ishim atje, mësuam se si mund të tregohet një lajm i mirë dhe një lajm i keq në një fjali – meritë kjo e Ekremit.

Nga shtegu rreth 18 km i gjatë, i cili kalohet për rreth 6 orë, shumë lehtë vërehet pjesa e majës së Lybotenit (kështu është emërtimi i Lubotenit nga ana e Republikës së Kosovës), maja e parë e malit Sharr, maje që në një farë forme bashkon bjeshkatarët e Kaçanikut dhe ata të Tetovës.

Afër aty është edhe fshati Llanishtë, fshat që ndër banorët lokal njihet për barsoletën e famshme gjatë kohës së komunizmit. Në fakt një banor i fshatit fqinjë, i hypur në pullaz të shtëpisë, tenton ta drejtojë antenën e "famshme" tokësore 5-12, drejt Shqipërisë , me qëllim që ti kap sinjalet e Radiotelevizionit Shqiptar. Rastësisht , në atë moment kalon një bashkëfshatar i tij, dhe e pyet se çka bën atje lartë. Pasi në atë kohë, ke mund të dënohesh nga regjimi jugosllav për ndjekje të emisioneve të shteteve që i kanë konsideruar armiq, ky i ngrati prej pullazit përgjigjet: "po du ti kapi valët e Llanishtës" (pasi fshati Llanishtë ka qenë në mes të trajektores së shtëpisë së tij dhe drejtimit të Shqipërisë). Prej atëherë në zhargonin e *kaçaniklive* ka mbetur si shprehje për dike që nuk kupton, t'i thuhet me shpoti – "ktheje ka Llanishta" (d.m.th. pranoje sinjalin mirë).

Vazhdojmë rrugëtimin drejt vendit ku duhet të kryhet ceremonia kryesore, dhe rrugës , tek një burim uji, jehon kënga e njohur e Kaçanikut "Ushton gryka e Kaçanikut", nga një bjeshkatar që zërin e kishte pushkë. Për një moment vërejmë se qenka këngëtari Salajdin Miftari, që u jep edhe më shumë energji bjeshkatarëve tjerë t'ia marrin këngës. E kështu më këngë e shaka, arrijmë te lugina ndër dushk, ku organizatorët kanë bërë një punë të mrekullueshme, duke siguruar drekë të denjë për dasma dhe pije freskuese për të gjithë pjesëmarrësit.

Sapo mbaron dreka, fillon ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve, dhe pasi të gjitha shoqatat pjesëmarrëse pajisen me mirënjohje për ecje në këtë shteg të pavarësisë, shoqata jonë dhuron një pllakat special për deputeten pjesëmarrëse në shpalljen e Kushtetutës së 7 shtatorit 1990, Feride .... Në pllakat përveç deklaratës së Kushtetutës qëndron edhe motoja që kurrë nuk do të shuhet..."Ushton Gryka e Kaçanikut".

Të lodhur e të rraskapitur, harxhojmë energjitë e mbetura, të kthejmë nga ana lindore e Kaçanikut, për në qytet, për të përfunduar në një nga kafeteritë e qytetit, për të bërë pushimin e fundit për në shtëpi.

Rrugës për kthim , devijojmë rrugën në anën e djathtë të grykës së Kaçanikut, dhe ngjitemi thikë për pjete, për të takuar edhe një fshat malor, Gajren, por

jo Gajren e Tetovës por atë të Kaçanikut. Rruga piktoreske, për shumicën e bjeshkatarëve e panjohur, na shpien drejt fshatit Strazhë, deri tek vendi që të gjithë e njohim si “shtëpia e pylltarëve” dhe na nxjerr pikërisht në kufirin e Jazhincës.

Rrugëtimi mbyllet me premtimin se edhe n ‘mot do jemi aty.



Kobilica me shkas

Përsëri 18 shkurti na gjen si në vitet pararendëse, të përgatitur për të ngjitur një nga majet më të bukura por edhe më sfiduese (sidomos në kushte dimërore), Majen e Kobilicës. Shoqata Bjeshkatare "Sytë e Sharrit" na ka ftuar ashtu si edhe viteve tjera që t'i bashkangjitemi në ngjitjen tradicionale drejt Majes së Kobilicës, që organizohet për nder të pavarësisë së Kosovës. Kjo ngjarje zhvillohet çdo vit, në të dielën më të afërt me datën 17 shkurt të atij viti, e që këtë vit ishte një ditë pas kremtimit të 16 vjetorit të pavarësisë së Kosovës.



Grupi i jonë po i afrohet turmës së madhe të bjeshkatarëve, të cilët herët në mëngjes janë vendosur përpara Pallatit të Kulturës. Me shumë kënaqësi përshëndetemi dhe shkëmbejmë biseda me bjeshkatarë të shumtë që kanë ardhur nga shoqëri të ndryshme bjeshkatare nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova dhe gjetiu.

Është interesant fakti që edhe pse kryefjala e organizimit është Kosova, ngjarja kryesore çdoherë zhvillohet në Tetovë dhe shumica e bjeshkatarëve kosovar participojnë me shumë kënaqësi dhe respekt për nikoqirët.

Pas fotografimit të përbashkët, me vetura, furistrada e ca me furgona, nisemi nga sheshi i Tetovës drejt fshatit Vicë. Vica është rreth 13 km në veri-perëndim të Tetovës dhe do të na duhen afërsisht 30 minuta për të arritur në destinacion. Me të kaluar fshatin Sellcë, Kobilica ose siç njihet nga banorët lokal Maja e Gjatë, sa vjen e na kthjellohet, e që kur shihet nga faqja jugore, të ngjan me piramidat e Keopsit. Duke e komentuar nga vetura në lëvizje për bukurinë dhe ashpërsinë e Kobilicës, dikush nga shokët tregon se si para 2-3 viteve kishin gjetur një person të ngrirë, rrugës për në Kobilicë. Viktima kishte qenë refugjat sirian, që me shumë gjasë nuk ka arritur të orientohet dhe të përshtatet me kushtet e ashpra klimatike të Sharrit, sidomos gjatë dimrit. Me gjithë keqardhjen e rastit në fjalë, dikush nga shokët thotë me shaka se duhet ta rishqyrtojmë edhe ne vendimin për ta ngjitur këtë maje, pasi rreziku është i lartë.

Arrijmë në fshatin Vicë, parkojmë veturat dhe nisemi në drejtim të Kobilicës. Shtegu është i shkurtë, por ka pjerrtësi të theksuar, e për të na lehtësuar këtë udhëtim, diku nga mesi i shtegut organizatorët na presin me çaj të ngrohtë, djathë dhensh, gjizë e produkte tjera të bulmetit. Me shumë ëndje ndalemi tek stani i vëllezërve Xhemaili, për të shijuar të mirat e jetës së fshatit, produkte bio të prodhuara në kushtet më organike të mundshme.


Pas mbi 5 kilometra ecje sfiduese, arrijmë në vendin e quajtur Qafa e Lubijës, që siç nënkuptohet emrin e ka marrë nga fshati Lubijë që gjendet në anën tjetër të kufirit dhe që është e pozicionuar shpinë për shpine me fshatin Vicë. Se bjeshka është e paparashikueshme, dëshmojnë dorezat e dimrit, të njërit nga bjeshkatarëve; ai i mban ato me vete përherë sepse në një nga ngjtijet e mëhershme në këtë vend, ngrica e Gushtit ja ka "rrzaue gishtat për thoj" shprehje krahasimore për motin e ftohtë! Një banor lokal na informon se kjo rrugë është përdorur për shkëmbime tregtare mes banorëve të Malësisë së Tetovës me Malësinë e Prizrenit. Përveç tjerash, e njëjta është përdorur edhe gjatë periudhës së luftës në Kosovë dhe Maqedoni për transport të furnizimeve të ndryshme. Pas këtij pushimi interesant, mbledhim energjitë e fundit dhe sforcohemi për të ngjitur kilometrin e fundit drejt destinacionit tonë.

Arrijmë në maje, të entuziazmuar dhe të mahnitur nga pamja që na ofrohet. Përkundër faktit se për shumicën e bjeshkatarëve kjo ngjitje nuk bëhet për herë të parë, megjithatë përjetimi mbetet i njëjtë, ashtu si në ngjitjen e parë.

Gjatë kthimit, edhe kësaj radhe nikoqirët na presin në vendin e njëjtë ku pushuam gjatë ngjitjes, për të na shërbyer drekën e ngrohtë. Groshë Vice, e

shoqëruar me ushqime tjera tradicionale, si për të na kompensuar lodhjen dhe energjitë e shpenzuara për ngjitje.

Pavarësisht organizimeve të shumta dhe të ndryshme për nderë të 17 shkurtit, ky organizim tashmë tradicional, mbetet pa dyshim një nga kremtimet më të bukura dhe më të veçanta.



Udha e bukës

Në një të kaluar jo edhe aq të largët (vitet mbas Luftës së Dytë Botërore) pjesa më e madhe ë Ballkanit është kapluar nga varfëria, si në produkte ushqimore ashtu edhe në bagëti. Kjo varfëri ka qenë edhe më e shprehur në viset malore, si rezultat I lidhjeve te dobëta infrastrukturore me qytetet.



Të mbërthyer nga varfëria dhe mundësitë e kufizuara që të mund të sigurojnë ekzistencën, banorët e Malësisë së Sharrit janë detyruar të kërkojnë burime të rregullta të ushqimit, e asokohe ushqim ka qenë drithi gjegjësisht mielli, apo siç kanë thënë të parët tanë "***mbush hambarin dhe shtremo ksulën***"!

Si pasardhës të disa prej atyre familjeve me vështirësi ekzistenciale, anëtarët e SH.B."Tetova" organizuan "Marshin e bukës", në shenjë respekti dhe konsiderate për të parët tanë. Kjo rrugë është frekuentuar prej fshatrave të Malësisë së Sharrit deri në Prizren dhe anasjelltas.

Me këtë rast ju sjellim disa nga përjetimet e treguara brez mbas brezi për peripecitë e udhëtarëve të bukës. Babai I doktorit po ashtu ka qenë "udhëtar i bukës", e ai mes tjerash ka thënë: (***Gjat dimnit bijte shaum vdor, kur mbrëjshim në Çaf të Xholit pa fund pi ka ona e Përzerenit, thasët e dhejnt* të mbushët me drith I shkarkojshim dhe I lshojshim të rrishesin ka nja 300 metre xhi të pushojn pak kojlt ene mushkat, ene mambrapa prap I ngarkojshim agje poash njen në Tetovë***).



Të shtunën, me 31.08.2024 në ora 7:30 filluam nga katundi Veshallë, drejt Kroit të Abazit për të vazhduar për në Qafën e Xholit pa fund, ku na priste anëtari i shoqatës sonë, Xhemil Veliu nga Zaplluzha e Opojës, njëherësh edhe student i fakultetit të mjekësisë në Universitetin e Tetovës.

Së bashku ia mësymë një teposhtëze të butë e të lezetshme deri tek vija e asfaltit mbi katundin Struzhë- tek Karaulla, ku bëmë një pushim duke pirë kafe e bë llafe, se kusha ka bërë *ma shaum punë*, Kosova këndej apo Maqedonia e Veriut andej.

Vazhduam me një furgon deri tek rruga ku ndahet nga vija e asfaltit për në Pasha çezmë, në këmbë pas nja një orë e gjysmë mbërritëm në Kalanë e Prizrenit,

për të zbritur në qytet- pjesa e vjetër, aty mu te shatërvani, apo para xhamisë së Sinan pashës dhe më në fund të vendosemi në hotel Kaçinari.


Të nesërmen, më 01.09 në ora 8,00 me transport të organizuar, vazhduam deri te pika e mbarimit të vijës së asfaltit, tek Karaulla, ku në këmbë ia mësymë së bashku me një anëtar të Sh.B. Sharri, për në majën e Skarpës lmd 2474, e ai na udhëhoqi, shoqëroi në mënyrën më të mirë deri në maje.

Në majën e Skarpës u ndamë në mënyrë vëllazërore, na duke vazhduar në majën mbi liqe, teposhtëzën për tek Kroi i Abazit e *drijt e hajtbir* për në Veshallë!

Ashtu siç dikur banorët e Sharrit kalonin kilometra të gjatë në këmbë për të siguruar ushqim, sot ne kalojmë të njëjtat rrugë në shenjë nderimi dhe respekti ndaj atyre përpjekjeve dhe sakrificave. "Marshi i Bukës" shërben jo vetëm si një kujtim i vështirësive të kaluara, por edhe si një mënyrë për të lidhur të tashmen me të shkuarën, duke na mësuar vlerën e punës dhe përkushtimit. Çdo hap në këtë udhëtim është një hap drejt mirëkuptimit të thellë të jetës së të parëve tanë, dhe një kujtesë që të vazhdojmë të vlerësojmë dhe të mbrojmë këto rrugë historike. Ky marsh është jo vetëm një traditë, por edhe një simbol i bashkimit dhe forcës së komunitetit që ndërmerr këto hapa së bashku, duke ruajtur një lidhje të çmuar mes brezave.

Shëndet e mbarësi miqtë e shoqatës sonë!

** thasët e " dhejntë", (thasë të thurur nga leshi I përpunuar I dhive)*



Kronikë nga Sharri

Ediela, është ditë që në kalendar është e rezervuar për shëtitje malore me anëtarët e grupit. Këtë të diel, qëllimet na u përputhën dy herë, e para përshkrim i një traseje malore të Malit Sharr, të përcaktuar me projektin e @ CNVP, dhe në anën tjetër, pjesëmarrja në eventin e organizuar nga Dani Farm, gjithashtu përfitues i granteve përkrahëse nga ana e @CNVP.

Si shpeshherë, takimi i bjeshkatarëve bëhet tek Teleferiku, ku pas organizimit në makinat transportuese, nisemi drejt pikës së fillimit të ecjes malore. E ajo pikë sot është vendi i quajtur "Pluhni", një vend nja 500 m lart fshatit Brodec. Aty parkojmë makinat, bëjmë foton e parë të grupit, i cili numëron rreth 20 anëtarë fillojmë ngjitjen deri tek stanet e Brodecit.



Foto 1: *Vendi i quajtur "Pluhni"*

Bjeshkatari që ka prejardhjen prej Brodeci me ëndje na tregon të dhëna karakteristike për këtë rutë. Kthejmë djathtas, që të hyjmë në një pyll me drurët e Ahut, që nga fshatarët njihet si Xhibre, për të mësuar pikën e dytë referuese të kësaj rruge, e cila quhet *Te qershia*. Në fakt, pema në fjalë nuk është qershi, por për shkak të ngjashmërisë fizike me pemën e qershisë, ajo ka mbetur edhe sot e kësaj dite një toponim. Ndërkaq, dikush nga bjeshkatarët veteran thotë se ky shteg është shfrytëzuar shumë edhe në fillet e bjeshkatarisë në këto troje , për të arritur deri te maja e Kobilicës (2528 nlm). Në këtë moment, në bisedë inkuadrohet edhe një anëtar nga fshati Vicë, duke komentuar se ne fshatarët këtë maje e njohim si *Maja e gjatë*, toponim që gjithashtu nuk duhet lënë pas dore.



Foto 2: Picërraku (*salamandra ose tritoni pikalosh*) *banon në pyjet gjetherënëse, në viset bregore pranë ujërave. Është shtazë e ngathtë dhe e ngadalshme, aktive gjatë natës-kur edhe del për në kërkim të ushqimit. Në kohën me shi mund ta shohim edhe gjatë ditës. Shumicën e kohës e kalon i fshehur në vendet të cilat i ofrojnë strehim dhe sasi të mjaftueshme te lagështisë. Tritonët jetojnë vetëm, por gjumin e bëjnë në grupe. Ushqehen me larva, kërmij, etj.*

Duke vazhduar me shëtitjen, befas shohim madhështinë e saj, Majen e Kobilicës, apo *Maja e gjatë*. E zbukuruar me borë të re, bardhësia e saj ja shton bukurinë edhe më shumë, thua ti se dëshiron të flasë, e të thotë – "Vetëm më guximtarët mund të më përballojnë , e ngjiten në këtë maje".



Foto 3: *Maja e gjatë (Kobilica)*

Jemi në bjeshkët e Brodecit dhe na shfaqet stani i parë në një pllajë, e cila në anë të majtë e ka si në pëllëmbë të dorës Majen e Titos dhe Ceripashinën.



Foto 4: *Maja e Titos dhe Ceripashina*

Një tregim interesant për ata më të rinjtë, që mbetën të çuditur se pse rruga që shpien drejt Kosovës dhe fshatit Lubi, në anën e Prizrenit, njihet edhe si rruga e drithit. Me vëmendjen më të madhe, ata dëgjuan sesi në një të shkuar jo shumë të largët, stërgjyshërit dhe gjyshërit e tyre kanë marrë rrugën ditore vetëm e vetëm për të siguruar një strajcë me miell, në kohët kur ka pas mungesë të miellit në këto troje. Vazhdojmë në atë drejtim dhe hyjmë përsëri në mal, ku si në përrallat gjermane për fëmijët na shfaqet Stani i Danit, i cili është ndërtuar me shumë përkushtim, dhe ka ruajtur atë tradicionalen brenda tij.



Foto 4: *Stani i Danit*




Foto 5: *Flija dhe bakërdari*

Aty na presin edhe mysafirët tjerë, së bashku me nikoqirët, dhe gostia veç më ka filluar. Sa të shijshme janë ushqimet tradicionale të këtyre trojeve. Të thjeshta në dukje, por të rënda për t'u gatuar, e gatimi i tyre zgjatë me orë të tëra. Një *bakërdar* (me bazë të miellit të misrit) më gjalpë duhet të përzihet shumë kohë, që të merr shijen e duhur. Po për *flijën* e famshme, apo *me rende* si thonë banorët e zonës as mos të flasim, sa e sa herë duhet të hiqet saçi, të nxehet, dhe përsëri të mbulohet materiali si qull, për t'u krijuar produkti final. Të gjithë këto shoqërohen edhe me djathin e bardhë të dhenve, si dhe me çajin e malit, i cili të deh nga aroma dhe përbërja e tij.

Shtegu është mesatar nga e lehta për bjeshkatarët dhe nuk merr më shumë se 4 orë vajtje ardhje, apo jo më shumë se 8km në të dy drejtimet.

Arrijmë përsëri te *Pluhni*, dhe komentojmë se si paska çel thana, *për të cilën një legjendë thot se kur zoti ka ndarë oraret se cila pemë kur do çele, thëna nuk ka pas durim të pret në rradhë dhe kur e ka marr vesht zoti se kjo ska durim, e ka beku që të çele e para, por ama të piqet e fundit.*

Deri në rrugëtimin e ardhshëm, me ose pa neve pët tu ngjit deri te Stani i Dani mund te konsultoni harten që vijon si dhe na ndjekni me informata të rëndësishme për bjeshkatarinë.



Dukati

Këtë fundjavë Shoqata Bjeshkatare Bukuritë e Sharrit, organizoi ngjitjen në Shavar, Liqenin e Gornjanit dhe Livadhet e Rakovecit. Një grup bukur i mirë i Shoqatës Bjeshkatare "Tetova" ju bashkëngjit kësaj ngjarje mjaft atraktive dhe mirë të organizuar.

Doktori së bashku me një pjesë të grupit po i presin anëtaret e tjerë tek restorant "Boss", që të nisemi së bashku drejt fshatit Pirok, prej ku edhe bëhet nisja e organizuar. Pas disa minutave shikon orën e dorës dhe si me padurim thotë "prap be u vonun këta djemt !". E të tjerët qeshin me përpikërinë e doktorit që si çdo herë kërkon të respektohet orari i paracaktuar. Pas disa minutave, pjesa e mbetur e grupit na bashkëngjitet dhe bëhemi gati për t'u nisur.



Pikëtakimi ishte përcaktuar në qendrën e fsh.Pirok, ku nikoqirët mbajtën fjalim rasti dhe nga ku na uruan mirëseardhje dhe na informuan në pika të shkurta për itinerarin e marshimit.

Nga aty, me vetura vazhduam deri në fshatin Rakovec, ku parkuam veturat edhe filluam ecjen. Këtë rrugë, një pjesë e madhe e grupit tonë e ka kaluar disa herë gjatë ngjitjes drejt Majes së Rudokës, Liqenit të Zi dhe Majes së Bristavecit. Pas rreth një orë ecje arrijmë tek Liqeni i Gorjanit (Xholi i Gorjanit), liqen artificial ky që është ndërtuar si pikë akumuluese e ujërave të kësaj ane të Sharrit dhe shërben për ujitjen e një pjese të fushës së Pollogut. E për më tepër, përveç ujitjes, ja shton edhe bukurinë natyrës.

E lëmë pas Xholin e Gorjanit dhe e vazhdojmë ecjen drejt shtëpisë malore, apo siç e quajnë vendasit Shavar. Këtu, nikoqirët na pritën në mënyrën më të mirë të mundshme, duke na gostitur me çaj mali dhe ëmbëlsira. Përveç tjerash, e gjitha kjo nën shoqërimin e këngëve të bukura qytetare, të përcjella me kitarë, nga grupi i bjeshkatarëve të Kaçanikut.



Ecjen e vazhduam drejt Livadheve të Rakovecit, duke dëgjuar shakatë e bjeshkatarëve dhe barsoleta të ndryshme, por barsoletat e doktorit (18+) si zakonisht janë më të mirat!

Në kthim nga pika e fundit e marshimit, u nisëm në të njëjtën rrugë nga erdhëm dhe u kthyem në fshatin Rakovec, ku na pritnin curlet dhe lodrat si dhe dreka e shijshme me groshë dhe hallvë.

Tek shkolla e fshatit, nikoqirët shpërndanë edhe lëvdata në shenjë falënderimi dhe respekti për pjesëmarrjen në ecje, gjë për të cilën ju jemi shumë falënderues dhe jo vetëm, por edhe për mikpritjen vëllazërore, ushqimin dhe zemërgjerësinë!

Ky eveniment tradicional është ndër të rallët që organizohet me kampnig ku të gjithë dashamiret e natyrës mund të shijojnë fjetjen në tendë dhe nën qiell të hapur.

Marshi i Nëntorit në Sharr

Tradita e Marshit të Nëntorit, e cila ka marrë jetë prej dy dekadash, vazhdon të jetë një nga eventet më të pritura dhe me ndikim për nder të Ditës së Flamurit më 28 Nëntor. Organizuar nga Shoqata Bjeshkatare "Sytë e Sharrit" në Tetovë, ky event ka arritur të bëhet një simbol i unitetit dhe krenarisë kombëtare, duke tërhequr pjesëmarrës nga e gjithë rajoni. Këtë vit, manifestimi filloi në mbrëmjen festive të 25 Nëntorit, në ambientet e ngrohta dhe mikpritëse të restorantit "Arra". Kjo hapje solemne solli një atmosferë të veçantë, ku darka e pasur shoqërohej me melodité e valleve dhe këngëve të folklorit shqiptar, duke nxitur një ndjenjë bashkësie ndër të pranishmit.



Mëngjesin e 26 Nëntorit, një numër i madh i pjesëmarrësve u mblodh në Sheshin e Tetovës, ku u përgatitën për udhëtimin drejt fshatit Sellcë. Ky fshat, i njohur për afërsinë me malësinë e Tetovës dhe si pikënisje për ngjitjen drejt majës Guri i Kuq, u bë pikëtakimi për të gjithë ata që dëshironin të bënin pjesë në këtë ngjarje simbolike. Përgjatë udhëtimit, kushtet e vështira atmosferike

dhe temperaturat deri në -5 gradë Celsius shkaktuan vështirësi, por mbizotëroi entuziazmi dhe vendosmëria e pjesëmarrësve. Pas një vonese të vogël, të gjithë arritën në vendstrehimin e tyre në Brezovicë, ku u parkuan dhe përgatitën për ecjen e ardhshme.

Pjesa e parë e ecjes drejt Gurit të Kuq zgjati rreth 40 minuta, te pika e parë e pushimit, në *Livadh të Begjit*. Ndërsa grupi i madh i pjesëmarrësve lëvizte nëpër shtigje të mbuluara me borë të freskët, peisazhet e mahnitshme malore ofronin një sfond të paharrueshëm. Arritja në Livadhin e Begjit solli një pushim të mirëpritur, ku vendasit kishin përgatitur një mikpritje të ngrohtë me patate të ziera, gjizë vendase dhe çaj mali, të cilat në ato kushte të ftohta u shijuan veçanërisht mirë.



Pas pushimit, ngjitja vazhdoi drejt majës ku flamuri shqiptar u ngrit me ceremoni të veçantë, një moment që përfshinte këngë patriotike dhe një ndjenjë të thellë krenarie. Kthimi në *Livadhin e Begjit* solli një ndryshim të këndshëm në menu, me kazanët e groshës tradicionale që zëvendësuan çajrat e mëparshëm. Banorët e Sellcës, të njohur për mikpritjen e tyre, ofruan një atmosferë festive

me muzikë dhe valle të rajonit, duke e bërë këtë pjesë të festimeve një kujtim të veçantë për të gjithë.

Në fund të ditës, ndërsa dielli perëndonte mbi kreshtat e Sharrit dhe hijet e gjata të maleve zgjateshin nëpër luginë, mbizotëronte ndjenja e pjesëmarrjes se ishin pjesë e një manifestimi unik, më të madh dhe më të rëndësishëm. Ky Marsh i Nëntorit, më shumë se një ngjarje festive, ishte një nderim i fortë i trashëgimisë dhe kulturës shqiptare, një rikujtim i rrënjëve dhe një betejë për të mbajtur gjallë kujtimet e luftës për liri dhe pavarësi. Kështu, ky event jo vetëm që bashkon njerëzit në një festë, por gjithashtu funksionon si një mjet për të forcuar identitetin kombëtar dhe për të ruajtur lidhjet me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e një kombi.

Korabi dhe lulja e Moravës

Me të zbardhur dita, fillon itinerari prej Tetovës për në drejtim të majës më të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Korabi. Ky udhëtim fillohet nëpërmjet fshatrave të Rekës, duke udhëtuar nga Dibra e Madhe-R.Maqedonisë, e deri në disa prej këtyre fshatrave siç janë: Nistrovë, Bibaj, Zhuzhnjë, Rimnicë, Grekaj, Tanushaj, Nivisht si dhe në pjesën tjetër të Strezimirit.



Ky masiv malor është plot e përplot me bukuri të rralla natyrore, me gurë, shkëmbinj dhe kullota, masiv i cili vizitohet nga shoqata të shumta alpinistësh, të cilët arrijnë të ngjiten edhe deri në majën e saj e cila ka lartësinë 2764 m. Këto kullota, në një të kaluar jo të largët kanë qenë nikoqirë të një numri të madh të bagëtive, e nga këto kullota ka “dalë” djathi shumë cilësor i dhenve, djathë i cili sot kërkohet si delikates shumë i çmuar nëpër objektet e hotelerisë.

Vargmali i Korabit shtrihet mbi 40 kilometra në drejtimin veri-jug, mes pjesës së poshtme të Drinit të Zi dhe lumit Radika. Ai është e vendosur rreth trekëndëshit kufitar të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës, në jugperëndim të maleve të Sharrit.

Korabi është një masiv shumë i thyer malor dhe përbëhet kryesisht nga shkëmbinj gëlqeror në anën veriore përbëhet nga shkëmbinj të thepisur. Një lloj i kulmit të dyfishtë, i Korabit arrin lartësinë 2756 m, e cila pothuajse ka të njëjtën lartësi, dhe është rreth 150 metra në veriperëndim të majës së Korabit, brenda territorit shqiptar. Në Juglindje, duke pasur pak zona shkëmbore, që ndajnë disa livadhe, arrihet shumë thjeshtë, dhe herë pas here edhe nga barinjtë me kopetë e tyre të dhenve. Gjatë ngjitjes për në Korab, rrugës haset një bimë e quajtur lulja e Moravës, e cila ka erë karakteristike e që është përdorur nga gjyshet tona është si mbrojtës I teshave nga brejtësit e ndryshëm. Poashtu në folklorin popullor ka një këngë, të cilën një anëtar i Shoqatës Bjeshkatare "Tetova", me të parë këtë lule ja nis ta këndojë: "*Oj lule morave, oj lule morave, kur dole a kave, kur dole a kave, kava po si s'kava pi nonës u ndava*". Kjo këngë në fakt ka përcjellë vajzat ditën e martesës.



Përveç majës së Korabit, ka disa maje të tjera, pothuajse në të njëjtin nivel të lartësisë mbidetare. Në veri të majave binjake ka një numër të shumtë të majeve tjera paemër, me kulla shkëmbore me lartësi pothuajse të barabartë. Maja gjendet rreth dy kilometra në jugperëndim, Porta e Korabit arrin 2727m e cila

edhe për nga pamja i ngjan një hyrje daljeje malore. Nja disa qindra metra në jug është një tjetër majë, maja e Moravës, e cila është 2718 m me vetëm pak metra më pak se maja më e lartë. Korabi poashtu është maja nga e cila, veçanërisht gjatë pranverës dhe me shkrirjen e borës lindin ujëvara spektakolare, si ajo në luginën e sipërme të lumit Përroi i Thellë, që arrin lartësi mbi 100 metra.

Për majën e Korabit flitet se është dera apo ndalesa kryesore që Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka klimë mesdhetare.

Korabi mbetet një thesar i natyrës dhe një sfidë për bjeshkatarët e apasionuar, bukuria e tij e papërsëritshme, me majat e thepisura, livadhet e gjelbra, dhe ujëvarat e larta, e bën këtë vargmal një destinacion të veçantë për të gjithë ata që duan të shijojnë fuqinë dhe magjinë e natyrës. Përveç pasurisë natyrore, Korabi mbart në vete histori dhe tradita, të cilat vazhdojnë të jetojnë në kujtimet e brezave. Ngjitja në këtë masiv nuk është thjesht një aventurë fizike, por një udhëtim nëpër bukuritë e Ballkanit, ku legjendat, këngët popullore, dhe erërat karakteristike të bimëve të rralla si lulja e Moravës, të përfshijnë dhe të rikthejnë tek thjeshtësia dhe madhështia e natyrës. Kështu, Korabi mbetet jo vetëm një simbol i lartësisë, por edhe një portë që të çon drejt shpirtit të maleve dhe pasurisë së papërshkrueshme të kësaj treve.

